




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipal Vitina

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 5, Rregullorja QRK Nr.9/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale të Qeverisë së Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.02/L-53 për Gjuejinë dhe Udhëzimin Administrativ Nr.06/2009 për Dhënien në Menaxhim të Vendgjuetive të Përbashkëta, në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal për Themelimin e Vendgjuetisë së Përbashkët të Komunës së Vitisë Nr.01-110/05-1284, të datës 04.12.2020, si dhe Vendimit Nr. 01-110/05-220, të datës 01.03.2022 për Formimin e Komisionit për Procedurat të Mëtutjeshme të Dhënies me Qira të Vendgjuetisë në Territorin e Komunës së Vitisë, hapjes së ofertave me dt.28.10.2022 dhe shqyrtimit i ofertave me dt.31.10.2022, komisioni shpallë këtë:

NJOFTIM PUBLIK

të shpalljes së fituesit të ankandit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër (prej 10 viteve) të pronës komunale

Hapja e ofertave të këtij ankandi është bërë me datën 28.10.2022, ndërsa vlerësimi dhe shqyrtimi i ofertave nga ana e komisionit është bërë me datën 31.10.2022 dhe pas vlerësimit ka përzgjedhur fituesin e ankandit, i cili ka ofruar ofertë të përgjegjshme me çmim më të lartë.

Komisioni vendos dhënien për kontratë për ankandin e dhënies me qira të vendgjuetisë në territorin e Komunës së Vitisë.

**Shoqatës për ruajtjen e egërsirave, gjueti dhe mbrojtje të ambientit "UJKU - GJILAN".
Vlera e kontratës është 30.111€.**

Palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh nga dita e shpalljes së njoftimit.

Viti: 01.11.2022

